

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GLLOGOC në procedurën kundërvajtëse të zhvilluar kundër të pandehuri Arben Tahir Morina nga Gllolari KK. Glllogoc , për vepër kundërvajtëse të kryer nga neni 5 , 6 paragrafi 1 pika 3 dhe neni 9 të Ligjit nr. 04/ L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lart Publik dhe deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personave zyrtar , e në vështrim të neneve 73,195 dhe 199 dhe 213 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë 30.11.2012 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Arben Tahir Morina i lindur më 14.01.1979 në Gllobar, Shqiptar ,shtetas i Kosovës , i gjendjes së mesme ekonomike, me parë jo i dënuar, dhe jo nënë hetime e me vendbanim të përhershëm në Gllobar KK. Glllogoc.

**Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse si Zyrtar i Lart Publik në pozitën Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal në Glllogoc , nuk ka bërë Deklarimin e Pasurisë të kërkuar nga Agjensioni Kundër Korrupsionit për vitin 2011 e të cilin deklarim nuk e ka kryer brenda afatit ligjor deri me 31.03.2012 e me këtë ka kryer vepër kundërvajtëse nga neni 5, 6 paragrafi 1 pika 3 dhe neni 9 të Ligjit nr. 04/ L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lart Publik , e të ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 3 . andaj:

**N D Ë S H K O H E T**

**ME GJOBË NË SHUMË PREJ 1500 (njëmijepesëqind) €,**

Gjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar të paguar në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmerisë së këtij aktvendimi, në xhirollogarinë nr. 1000430070000518, e në të kundërtën do të merret aktvendim i ri në vështrim të nenit 5 të Ligjit mbi Kundërvajtje, ku ndëshkimi i shqiptuar në të holla do të zëvendësohet me ndëshkim burgu ,duke llogaritur 15 €,me një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës kundërvajtëse nuk ka pasur.

**OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën në larësi prej 5 € (pesë).

Me një kopje të këtij Aktvendimi njoftohet i pandehuri dhe paraqitësi i kërkesës.

**A r s y e t i m**

Agjensioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me kërkesën e vetë nr. 01-2359/12 të datës 02.07.2012 , ka kërkuar që të zhvillohet procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Arben Morina nga Gllolari KK. Glllogoc për vepër kundërvajtëse nga neni 5 , 6 paragrafi 1 pika 3 dhe neni 9 të Ligjit nr. 04/ L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lart Publik.

Gjendja faktike dhe reale është vërtetuar në Gjykatë pas dëgjimit të deklaratës së t' pandehurit në seancë gjyqësore të mbajtur më date 29.11.2012.

I pandehuri Arben, në deklaratën e tij theksoj se: është e vërtet se unë personalisht brenda afatit ligjor nuk e kam plotësuar dhe dorëzuar në Agjensionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë formularin për deklarimin prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë për zyrtar të lart publik me arsyetim se nuk ka pasur mundësi sepse në këtë periudhë e ka pasur babain të sëmur dhe në operim jashtë vendit e së bashku me te ka qenë personalisht edhe vet dhe se i njëjti në këtë periudhë ka qenë në Gjermani , ndërsa në momentin kur është kthyer në Kosovë nga zyrtaret publik Komunal i është thënë se i njëjti duhet të deklaroi pasurinë dhe të plotësoi formularin në fjalë , e në bazë të kësaj i njëjti potencon se unë kam vepruar ashtu dhe me datën 17.04.2012 e kam dorëzuar formuarin në fjalë e kam dorëzuar në Agjensionin për Anti Korrupsion në Prishtinë dhe atë personalisht dhe për këtë posedon dëshminë-vërtetimin me nr. 03-3441/12 të datës 17.04.2012 .

§

REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENSIONI KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Nr. Prot. 444/DOO Nr. Esh. / Bru. / Nr. pages /	Nr. Prot. 03/4471/12 Nr. Esh. / Bru. / Nr. pages /
Datë: 14.12.12	

Po ashtu në seancë gjyqësore për këtë çështje u dëgjua edhe përfaqësuesi i Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë Agron Behrami sipas autorizimit nga ky Agjencion me nr. 013487/12 të datës 03.10.2012 e i cili deklaroi se Zyrtari i Lart Publik Arben Morina-Këshilltar në Kuvendin Komunal në Glllogoc brenda afatit ligjor në bazë të ligjit ka qenë i obliguar që të plotësoi formularin për deklarimin e pasurisë, ndërsa i njëjti nuk e ka dorëzuar atë edhe pse ka qenë obligim ligjor i tij e po ashtu i njëjti Agjencioni Kundër Korrupsionit nuk e ka paralajmëruar se eventualisht nuk mund të plotësoi formularin në fjalë për arsyet e tij subjektive andaj Agjencioni ka qenë i obliguar që të bëjë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit Arben në Gjykatë, edhe pse i njëjti me datën 17.04.2012 jashtë afatit ligjor e ka dorëzuar formularin në Agjencion.

Ndaj të pandehurit Arben Morina kemi bërë kërkesë për fillim të procedurës sepse nëpër mjet zyrtarëve kontaktues në Institucione e ne këtë rast nëpërmjet Bekim Morinës Zyrtar në Kuvendin Komunal në Glllogoc jemi njoftuar me shkresë të veçantë me nr. 31-1698 të datës 10.02.2012 me të cilën shkresë jemi njoftuar me datën 02.03.2012 se edhe i pandehuri Arben Morina është në listën e Zyrtarëve Publik dhe është i obliguar që të bëjë këtë deklarim të pasurisë nëpërmjet formularit të veçantë në Agjencionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ndërsa i njëjti nuk ka vepruar konform kërkesës së Agjencionit.

Pas dëgjimit të deklaratës së të pandehurit Arben, si dhe përfaqësuesit të Agjencionit Kundër Korrupsionit Agron Behrami, shqyrtimit të shkresave të lëndës veç e veç dhe administrimit të provave, Gjykata erdhi në përfundim dhe konstatoj se në rastin konkret ekzistojnë vetit dhe tiparet e veprës kundërvajtëse të kryer nga neni 5, 6 paragrafi 1 pika 3 dhe neni 9 të Ligjit nr. 04/ L/50 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lart Publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personave zyrtar, e për këtë Gjykata të pandehurin Arben, e ndëshkoj me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijepesëqind) €, si dhe 5 € paushall gjyqësor dhe me rastin e shqiptimit të ndëshkimit, Gjykata pati për bazë rrethanat lehtësuese dhe renduese dhe si rrethanë lehtësuese mori për bazë atë se i pandehuri Arben me datën 17.04.2012 ka deklaruar dhe plotësuar formularin për deklarimin e pasurisë së prejardhjes dhe gjendjes së pasurisë ku si dëshmi nga i pandehuri është ofruar vërtetimi nr. 03-3441/12 i të njëjtë datë, ndërsa si rrethanë renduese pati për bazë atë se i njëjti edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt për seancë të rregullt gjyqësore për datën 04.10.2012 nuk ka qenë prezent duke mos paralajmëruar dhe as arsyetuar mungesën për këtë seancë gjyqësore e po ashtu i njëjti edhe me datën 19.10.2012 e ka vështirësuar mbajtjen e seancës së rregullt gjyqësore me arsyetim nga familjarët e tij se i njëjti nuk gjindte brenda vendit.

Gjykata pasi që mori për bazë te gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së kryer në të njëjtën seancë gjyqësore te pandehurit Arben e shpalli fajtor dhe i deklaroi ndëshkimin me gjobë në shumë prej 1500 € në mënyre verbale se i njëjti ndëshkohet me gjobë në shumë prej 1500 € për kundërvajtjen nga neni 5, 6 paragrafi 1 pika 3 dhe neni 9 e i sanksionuar sipas neni 17 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit 04/L 050 dhe pas shqiptimi dhe njoftimit me ndëshkimit i pandehuri Arben hjek dorë nga Ankesa dhe premtion se brenda afatit ligjor do të kryej këtë obligim ligjor


Me sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GLLLOGOC

Rexh-I-Nr. 4325/12

Data : 30.11.2012

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi ushtruesi i kërkesës mund të ushtroi ankesë me afat prej 8 ditësh, pas marrjes së të njëjtit Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.



Gjyqtari  
Vesël Gorani